

STATUT I SHOQERISE

"KH ENERGY" SHPK

Ky statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi I te ciles rregullohet ketu.

KAPITULLI I

THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT

Neni 1

Themelimi, Forma dhe Ortaket

Sot me date 05.09.2023 ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ermin "KH ENERGY" SH.P.K.

Themeluesit e shoqerise jane:

- **Klaudio Hysa**, shtetas shqiptar, lindur ne Itali, Frosinone, me 13.07.1997, banues ne Tirane, mbajtes I kartes se identitetit nr. J70713070N

Ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratoi kete Statut si vijon:

Ne kete Statut:

- "Ligji" eshte Ligji 9901/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", I ndryshuar;
- "Statuti" eshte ky Statuti I Shoqerise

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Studimi, projektimi, ndertimin dhe operimin e paneleve diellore fotovoltaike dhe sistemeve te energjise diellore, ku perfshihet financimi, ndertimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi dhe shperndarja e energjise elektrike. Projektimin, ndertimin, mirembajtjen dh funksionimin e impianteve per prodhimin e energjise elektrike. Projektim, ndertim, rikonstruksion, montime, gërmime dheu, murature. Prodhim materiale ndertimi. Ndertime civile, industriale dhe

bujqësore, ndërtime banese. Ndërtime rrugore, hekurudhore, hidraulike, punime restaurimi dhe punime shërbimi.
Kompania ka te drejte qe te ushtroje cdo aktivitet tjeter te lejuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise

Neni 3

Objekti i Shoqerise

Shoqeria mund te kete si pjesemarrje dhe interesa ne shoqeri te tjera ose ndermarrje te tjera qe kane objekt te njejte, te ngjashem ose te lidhur me objektin e vet; mund te kryeje operatione financiare, ne lidhje me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme ne funksion te veprimtarise apo te objektit te vet. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te Shoqerise.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqerise eshte *Tirane, Kashar, Rruga Kastriotet, Perballe Spitalit Hygeia, Pallati Emira, Shkala 1, Ap. Nr.4 ,kati 5*

4.2 Transferimi i Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

4.3 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj.

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise

5.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje periudhe te pakufizuar.

5.2 Shoqeria mund te priset ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve.



KAPITULLI II

KAPITALI THEMEITAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE KAPITALIT

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10.000 (dhjete mije) leke.

6.2 Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kotributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues eshte Klaudio Hysa: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjitheshme 10.000 (dhjete mije) Leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 7

Rritja e kapitalit themeltar

7.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve sipas nenit 11.2.

7.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, kuotat e ortakeve te shoqerise do te rriten sipas shumave te percaktuara ne vendimin e asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve.

Neni 8

Zvogelimi i kapitalit themeltar

8.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuara nga ligji .

8.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve sipas shumave te percaktuara ne vendimin e asamblese se Jashtezakonshme.

Neni 9

Transferimi I kuotave te kapitalit dhe e drejta e parablerjes

9.1. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve sipas nenit 73 te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ",



9.2 Ne rast transferimi te kuotave te kapitalit ne cdo lloj forme personave te trete, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim, me cdo kusht, duke perfshire edhe dhurimin e kuotave, ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes mbi keto kuota kapitali.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORETDHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 10

Asambleja e ortakeve

10.1 Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

10.2 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i pjeseve te kapitalit qe zoteron.

10.3 Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tieter ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me ane te se ciles mund te jape voten e tij.

10.4 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, neqofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

10.5 Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej Administratoreve ose nga nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5%(pese perqind) te kapitalit themeltar. Ne cdo rast, Asambleja thirret te pakten nje here ne vit, jo me vone se fundi i muajit te Qershorit per te diskutuar, vleresuar dhe miratuar bilancin e vitit te fundit financiar.

10.6 Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve te pakten 7(shtate) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te mbaj informacion mbi llojin e Asamblese, mbi ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat duhet te merret vendimi mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dvte.

10.7 Asambleja do te quhet rregullisht e mbledhur edhe nese formalitetet e thirrjes nuk respektohen, nese ortaket qe perfaqesojne kapitalin e plote jane te pranishem apo te perfaqesuar dhe jane dakord te mbajne mbledhjen edhe formalitetet e lartpermendura nuk jane respektuar.

10.8 Cdo Asamble drejtohet nga Kryetari i emeruar ndermjet ortakeve ose personave te trete. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo ortak, ne se prania e noterit nuk eshte e nevojshme.

10.9 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj. Mbledhjet e Asamblese mund të mbahen edhe nepermjet telekonferencës dhe video konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe ti lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

Neni 11

Kuorumi dhe kompetencat e Asamblese

11.1 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme, të cilat merren me shumicë të zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë më shumë se 51% të kapitalit. Në rast mungese të këtij kuorumi në mbledhjen e parë, Asambleja thirret në mbledhjen e dytë me të njëjtin rend dite jo më vonë se 7 (shtatë) dite pas mbledhjes së parë. Në mbledhjen e dytë Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë që përfaqëson më shumë se 51% të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është kompetente për çështjet e mëposhtme:

- Miraton llogarinë vjetore dhe raportet financiare vjetore si dhe raportet vjetore për punën e Kompanisë në vitin paraprak afarist dhe vendos për shpërndarjen e të ardhurave dhe mbulimin e humbjes;
- Zgjedhja dhe revokimi i Menaxherit, pra menaxherëve të tjerë, nëse Shoqëria zgjedh më shumë menaxherë dhe vendos për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet kompanisë dhe menaxherit.
- Zgjedhja e Kompanisë së Auditimit për llogaritë vjetore të Kompanisë
- Marrja e vendimeve për masat e ekzaminimit dhe kontrollit të punës së Shoqërisë
- Marrjen e vendimit për fillimin e procedurës për kompensimin e dëmit të cilin Shoqëria ka pësuar në lidhje me themelimin dhe menaxhimin e saj ndaj menaxherit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës ose kontrollorit (nëse shoqëria ka ose ka pasur një organ mbikëqyrës)
- Marrja e vendimit për caktimin e avokatit për kontestet, nëse kompania nuk mund të përfaqësohet nga menaxheri



- Miratimi i marrëveshjeve për furnizim me më shumë se një të pestën e stokut të kapitalit
- Miratimi i Marrëveshjeve që shoqëria lidh me themeluesin, menaxherin ose të afërmit e tyre në vijë të drejtë pa kufizim dhe vijë anësore deri në nivelin e tretë, përveç rasteve kur ato marrëveshje janë lidhur sipas kushteve të zakonshme të punës së Shoqërisë.
- Marrja e vendimeve për vendosjen e një pengu ose hipotekë mbi asetet e Kompanisë
- I jep pëlqimin Menaxherit, nese Menaxheri për lidhjen e Marrëveshjeve në emër të Shoqërisë, shuma e të cilave nuk kalon 10.000 EUR.
- I jep pëlqimin Menaxherit, nese Menaxheri për lidhjen e marrëveshjeve të qirasë në emër të Shoqërisë, shuma e të cilave nuk kalon 5.000 EUR.
- Vendimi për ndryshime në Marrëveshjen e Shoqërisë dhe kryerja e aktiviteteve të tjera në përputhje me nevojat e Kompanisë dhe të gjitha rastet e tjera të parashikuar ne ligj.

11.2 Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme, të cilat merren me shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm të gjithë ortakët me të drejtë vote dhe votat janë marrë që përfaqësojnë më shumë se 71% të kapitalit. Në rast të mungesës së këtij kuorumi në mbledhjen e parë, asambleja e Jashtëzakonshëm thirret në mbledhjen e dytë me të njëjtin rend dite jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas mbledhjes së parë. Në mbledhjen e dytë, Asambleja e Jashtëzakonshme merr vendime me shumicë të thjeshtë që përfaqëson më shumë se 51% të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e asamblese së Jashtëzakonshëm është kompetente për këto çështje:

- Ndryshimet në Statut
- Ndryshimi i fushëveprimit të përcaktuar të punës së kompanisë
- Rritja ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë
- Shpërndarja e fitimeve
- Vendim për ndërprerjen e shoqërisë
- Riorganizimi dhe bashkimi i shoqërisë dhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Neni 12

Administrimi

12.1 Shoqeria administrohet nga 1(nje) Administrator I cili qendron ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen, per nje periudhe prej 5(pese)vjet me te drejte rizgjedhjeje nga Asambleja per te njejten periudhe.

12.2 Administratori/et mund te ndermarrin te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshernte shoqerise, me perjashtim te atyre qe ju rezervohen organeve te tjera te shoqerise nga ky statut apo ligji i zbatueshem.

12.3 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i perket Administratorit. Administratori I Shoqerise eshte **Z.Klaudio Hysa**, shtetas shqiptar, lindur ne Itali, Frosinone, me 13.07.1997, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me ID nr. J70713070N .

12.4 Admmistratori/et mund te emeruje/ne perfaqesues te posacem per akte te vecanta ose per kategori aktesh .


Neni 13

Eksperti kontabel i autorizuar

13.1 Ne rast se percaktohet nga ligji apo kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

13.2 Eksperti kontabel i autorizuar do te emerohet per 1(nje) vit ushtrimor financiar dhe do te mbaroje mandatin e tij ne daten e asamblese se mbledhur per miratimin e bilancit te vitit te kaluar ushtrimor, me te drejte rizgjedhje.

13.3 Eksperti kontabel i miratuar mund te revokohet sipas normave te legjislacionit ne fuqi.



KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR ,BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 14

Viti financiar dhe bilanci vjetor

14.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.

14.2 Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise prane Oendres Kombetare te Biznesit (QKB) dhe perfundon ne 31 dhjetor te atij viti.

14.3 Bilanci vjetor, inventari, relacioni i Administratorit/ve dhe eventualisht i ekspertit kontabel (nese eshte emeruar) do te miratohen nga Asambleja sipas shumices se percaktuar ne ligjin 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

14.4 Miratimi i dokumenteve qe kane te bejne me vitin ushtrimor do te behet brenda 6 muajve nga data e mbarimit te vitit ushtrimor.

Neni 15

Fitimet

15.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci duke zbritur 5%(peseperqind) per rezerva ligjore deri ne arritjen 10%(dhjete perqind) te kapitalit si dhe shumat e tjera qe mund te lene menjane Asambleja e jashtezakonshme me vendim, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.

15.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jshtezakonshrne ose per qellime te tjera apo edhe shtyrjen e shperdarjes se Fitimeve , plotesisht ose pjeserisht, per vitet e tjera financiare.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMII SHOQERISE

Neni 16

Prishja

16.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e paparashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.



16.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesise juridike, vdekjes ose falimentimit te ortakeve.

Neni 17

Likuidimi

17.1 Ne rast prishjeje, Shoqeria duhet te likujdohet.

17.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e jashtezakonshme emeron nje ose me shume likujdatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te bilancit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

17.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit Asambleja e Jashtezakonshme do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likujduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

17.4 Pas pagimit te kreditorëve dhe mbledhjes se kredive, likujdatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit te ortakeve, ne proporcion me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarreshjeve

18.1 Te gjitha mosmarreshjet midis paleve qe mund te lindin ose lidhen me interpretimin dhe/ ose zbatimin e ketij Statuti dhe Akti te Themelimit si dhe ne pergjithesi cdo mosmarreshje qe mund te lind mes ortakeve (pervec mosmarreshjeve qe kane te bejne me raporte personale dhe nuk lidhen me shoqerine), ose midis disa ortakeve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim midis paleve me diskutim te drejtperdrejte te te interesuarve

18.2 Nese nuk arrihet qe nje mosmarreshje te zgjidhet me mirekuptim, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve.



Neni 19

Gjuha

19.1 Ky Statut nenshkruhet ne 2(dy) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKET

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"KH ENERGY" SH.P.K.

Klaudio Hysa

Klaudio Hysa
